

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtari Nikollë Komani, kryetar i trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në lëndën penale kundër të akuzuarve A. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së dhe ndaj të akuzuarit E. F. nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I nr. 32/2018 të datës 25.02.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë **30.04.2019**, në prezencën e prokurorit Ali Uka, të akuzuarit A. M. dhe mbrojtësit të tij D. D., avokat në Gjakovë, të akuzuarit E.F., me datë 02.05.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë **03.05.2019** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. M.**, i biri i S. dhe Z., e gjinisë B., data e lindjes... në fshatin ..., Komuna Gjakovë, tani me banim në ... rr." I. L." llamella ..., kati .. Lagja T..., i martuar, atë i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, kamarier, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

I akuzuari **E. F.**, i biri i H. dhe Xh., e gjinisë R., i lindur data e lindjes... në ..., tani me banim në Gjakovë, rr. "B. C.", nr..., i martuar, atë i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme, punëtor, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

I akuzuari A.M.

ËSHTË FAJTOR

Sepse pa autorizim ka blerë me qëllim shitje substancë narkotike e cila me ligje është shpallur si narkotikë, në atë mënyrë që ditën kritike me datë 25.05.2018 rreth orës 14:40 në Gjakovë hetuesit e njësisë për Hetimin e trafikimit me narkotikë-DHTN në Gjakovë gjatë zbatimit të masave të fshehta të hetimit ndaj të pandehurit A. M. me nofkën "S." në rr."P.K." në Gjakovë, ka ndaluar të pandehurin E., i cili është takuar me A. M. nga i cili ka blerë substancë narkotike të llojit heroin dhe gjatë kontrollës fizike të bërë në trupin e të pandehurit A., është gjetur (1) qese najloni e tejdukshme e mbushur me substancë në formë pluhuri ngjyrë kafe e dyshuar substancë narkotike e llojit heroinë me peshë prej 3.67gram, ku nga ekzaminimi laboratorik i forenzikës me numër ...2334 të pranuar në PTH me datë 14.02.2019 është konstatuar se dëshmitë #1 kishte në posedim 3.30 gram, substancë narkotike të llojit heroin.

- **me çka ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së.**

I akuzuari E.F.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 25.05.2018 rreth orës 14:40 në rr. "P.K." në Gjakovë pa autorizim posedon narkotik substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 14 të Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekusore nr. 02/L-128 dhe atë të llojit heroin në atë mënyrë që gjatë ndalimit dhe kontrollit të pandehurit nga hetuesit e njësitit për hetimin e trafikimit me narkotikë DHTN në Gjakovë, tek i pandehuri në dorë i është gjetur një paketim i letrës, i mbushur me substancë në formë pluhuri ngjyrë kafe e dyshuar substancë narkotike e llojit heroin me peshë prej 0,29 gram, e cila është konfiskuar nga policia, ku nga ekzaminimi laboratorik i forenzikës me numër ... të pranuar në PTH me datë 14.02.2019 është konstatuar se dëshmia #2 kishte në posedim 0,11 gram substancë narkotike të llojit heroin.

- me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 6, 17, 41, 43, 45, 46, 73, 74, 75, 76, par. 1 nën par. 1.4, 273 par. 1, 275 par. 2 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, i:

G J Y K O N

Të akuzuarin **A. M.** dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, si dhe Dënim me gjobë në shumën prej 1200,00 € (njëmijë e dyqind euro), të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afatin prej 1 (një) muaji, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë ditë) duke ia llogaritur 20,00 €, për një ditë burgimi.

Të akuzuarin **E. F** dënim me gjobë në shumën prej 600,00 € (gjashtëqind euro), të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afatin prej 1 (një) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë ditë) duke ia llogaritur 20,00 €, për një ditë burgimi.

Detyrohen të akuzuarit që secili veç e veç ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 50,00 €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50,00 €, në afatin prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohen substancat narkotike të llojit heroinë me peshë prej 3.30 gram dhe 0.11 gram si objekt i kryerjes së këtyre veprave penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP/I nr. 32/2018 të datës 25.02.2019, ka akuzuar A.M. nga ... për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së dhe të akuzuarin E.F. nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata pas pranimit të aktakuzës me parashtrësën PKR. nr. 11/19 të datës 14.03.2019, ja ka kthyer aktakuzën Prokurorisë Themelore në Gjakovë në plotësim, që të shikohet se kualifikimi juridik i veprës penale nga neni 275 par. 1 të KPRK-së, për të akuzuarin E.F. i është në rregull, duke u bazuar në sasinë e narkotikëve të gjetur te ky i akuzuar, pastaj marrëveshja për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të prokurorisë, mbrojtësit dhe të akuzuarit A.M. PP/I nr. 32/2018 e datës 03.08.2018, a është hartuar konform dispozitave ligjore, si dhe të deklarohen lidhur me shumën e të hollave prej 135,00 €, të cilat janë sekuestruar nga i akuzuari A.M. , pasi me urdhëresën e prokurorisë PP/I nr. 19/18 i datës 03.08.2018 është urdhëruar policia që këto të holla ti kthehen të akuzuarit A., ndërsa në aktakuzë është propozuar konfiskimi i këtyre të hollave.

Prokuroria Themelore në Gjakovë me parashtrësën PP/I nr. 32/18 të datës 26.03.2019 duke vepruar sipas kërkesës së gjykatës, lidhur me të akuzuarin E. F. ka bërë rikualifikimin e veprës penale, ku në vend të nenit 275 par. 1 të KPRK-së, ka konstatuar se duhet të jetë nenit 275 par. 2 të KPRK-së. Ndërsa sa i përket propozimit për konfiskimin e të hollave në shumën prej 135,00 €, të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale janë tërhequr nga ky propozim për konfiskimin e këtyre të hollave, sepse pas verifikimit kanë konstatuar se kjo shumë e të hollave nga prokurori i çështjes është urdhëruar që ti kthehen të akuzuarit, ndërsa lidhur me marrëveshje mbi pranimin e fajësisë se lidhur me datë 03.08.2018, pas konsultimit me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë ngelin pranë marrëveshjes, duke i propozuar gjykatës që nëse vlerëson që marrëveshja nuk është lidhur konform dispozitave ligjore të veprohet sipas nenit 233 par. 16 të KPRK-së.

Gjykata me datë 30.04.2019 e ka caktuar shqyrtimin ku e ka refuzuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP/I nr. 32/2018 të datës 03.08.2018, të lidhur në mes të prokurorisë, mbrojtjes dhe të akuzuarit A.M. dhe ka vazhduar me shqyrtimin fillestar.

Prokurori Ali Uka fillimisht ka deklaruar se sa i përket të akuzuarit E.F. ashtu si në parashtrësën e prokurorit të çështjes kualifikimi juridik duhet të jetë posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par. 2 të KPRK-së. Pas leximit të aktakuzës dhe deklarimit të dy të akuzuarve se e pranojnë fajësinë për veprat penale sipas aktakuzës, ka theksuar se janë të bindur se ky pranim i fajësisë nga ana e dy të akuzuarve është bërë me vullnet, pa presion dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat e siguruara gjatë procedurës së hetimeve e të propozuara me aktakuzë, ashtu që i propozon gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovoi. Ka shtuar se propozon që bazuar në nenin 273 par. 5 dhe 275 par. 3 të KPRK-së, substancat narkotike të llojit heroin në sasi prej 3.30 gram dhe 0,11 gram të konfiskohen, si dhe ka propozuar që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për dy të akuzuarit, si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M. , avokati D. D., ka deklaruar se pranimi i fajësisë së bërë nga ana e të mbrojturit të tij është në pajtim me dispozitat ligjore dhe pas konsultimeve paraprake ku të njëjtit ja ka sqaruar favorret e pranimit të fajësisë, andaj i propozon gjykatës që ky pranim i fajësisë të aprovohet. Ka shtuar se si rrethanë lehtësuese me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merret pranimi i fajësisë, gjendja e varfër ekonomike, jeton me qira, është baba i një fëmije, mbajtës i vetëm i familjes, ka kryer me sukses rehabilitimin dhe nga dita kritike nuk ka përdorur më lëndë narkotike, andaj i propozon gjykatës që bazuar në dispozita ligjore ti shqiptohet një dënim sa më i ulët.

I akuzuari A. M. ka deklaruar se e ka të qartë aktakuzën, nuk kërkon sqarime shtesë dhe duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se e pranon në tërësi fajësinë, është penduar, ka filluar që të punoi dhe premtori se më nuk do të kryen vepra penale.

I akuzuari E. F. ka deklaruar se e ka të qartë aktakuzën, nuk kërkon sqarime shtesë dhe lidhur me fajësinë ka theksuar se e pranon në tërësi fajësinë, duke shtuar se nuk është duke konsumuar substanca narkotike, është në rehabilitim dhe mbikëqyrjen e mjekut dr. I. G..

Pasi gjykata ka fituar bindjen se të akuzuarit A. M. dhe E. F. e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, për veprat penale që ju vihen në barrë dhe është bindur se pranimin e fajësisë e kanë bërë në baza vullnetare, pa presion, e i akuzuari i parë pas konsultimeve paraprake me mbrojtësin e tij, gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat e bashkëngjitura aktakuzës si raporti i ekspertimit i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë i datës 06.02.2019, procesverbali mbi bastisjes e banesave dhe personave i datës 25.05.2018, raporti i oficerit i datës 25.05.2018, foto-albumi, dëftesa mbi konfiskimin e pronës-narkotikëve e datës 25.05.2018 nga dy të akuzuarit, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par. 4 të KPP-së dhe shqyrtimin e ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Për të akuzuarin A. M. si rrethanë rënduese ka marrë parasysh faktin se ka qenë i dënuar për vepra penale të natyrës së njëjtë dhe atë në lëndën penale P.nr. 44/07, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, si dhe në lëndën penale P.nr. 540/09 dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, ndërsa për të akuzuarin E.F. përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale në mënyrën, kohën dhe vendin të përshkruar si në dispozitivin e II-të, të aktgjykimit nuk ka gjetur rrethana rënduese. Ndërsa si rrethana lehtësuese për dy të akuzuarit ka marrë parasysh pranimin e fajësisë që nga fillimi i shqyrtimit, pendimin e tyre, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit, e të cilat rrethana lehtësuese kanë ndikuar që për të akuzuarin A.M. përkundër faktit që edhe më parë ka qenë i dënuar, duke pasur parasysh edhe sasinë e vogël të substancave narkotike, gjykata ti aplikoi dispozitat e zbutjes së dënimit të paraparë me nenin 76 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, ti shqiptohet dënim në minimumin e paraparë ligjore dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve si dhe dënim me gjobë në shumën prej 1200,00 €, ndërsa të akuzuarit E. F. ti shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 600,00 €, me bindjen e plotë se këto dënime janë në harmoni me peshën e veprave penale, shkallën e përgjegjësisë dhe personaliteteve të akuzuarve dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarve do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskimin e substancave narkotike të llojit heroin në sasi prej 3.30 gram dhe 0.11 gram, është marrë bazuar në nenin 273 par. 5 dhe 275 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi që të akuzuarit secili veç e veç ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 50,00 €, është marr bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2, nën par.2.6 të KPP-së, si dhe shumën prej

50,00 € për kompensimin e viktimave të krimit është marrë bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/L-036.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
PKR. nr. 11/19 datë 02.05.2019

Sekretarja juridike
Mandushe Doli

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Nikollë Komani

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afatin prej 15 ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.